

# STATUT

## “FOREL” SHPK

### PJESA E PARË DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

#### Neni 1 Ortaku Themelues

Sot më datë 01.03.2021 Ortaket e Shoqërisë “FOREL” sh.p.k. vendosën që në bazë të ligjit të hartojnë dhe miratojnë këtë akt i cili përbën njëkohësisht statutin dhe aktin e themelimit e kesaj Shoqërie, me përmbajtje si më poshtë vijon:

1.1 Shoqëria është themeluar nga Ortakët e mëposhtëm:

- Zj. Vangjeli Kotonika, e bija e Dhimitër dhe Evgjeni, e dtl. 01.05.1940, Lindur në Korçë dhe banuese në Tiranë, madhore, me zotësi të plotë për të vepruar, identifikuar nëpërmjet kartës së identitetit nr, personal E05501169Q, adresë: Rruga “Ali Pashë Gucia” Tiranë.
- Haxhire Kasaj, e bija e Fatmir dhe Merjeme, e datëlindjes 23.01.1982, lindur në Lushnje dhe banuese në Tiranë, madhore, me zotësi të plotë për të jetuar, identifikuar nëpërmjet kartës së identitetit, nr, personal I 25123102 W, adresë: Rruga “Sitki CICO” Tiranë
- Anisa Tahiraj, e bija e Bashkim dhe Valbona, e dtl. 29.04.1981, lindur dhe banuese në Tiranë, madhore, me zotësi të plotë për të jetuar, identifikuar nëpërmjet kartës së identitetit, nr, personal I 15429104 K, adresë: Rruga “Vaso Pasha”, pll.1/2Tiranë

1.2 “FOREL” sh.p.k. është shoqëri me përgjegjesi të kufizuar me datë themelimi 01.02.2021 në përputhje të plotë me Ligjin Nr. 9901, dt. 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar dhe që funksionon në përputhje me dispozitat e këtij Statuti.

1.3 Emri i shoqërisë është “FOREL” sh.p.k.

1.4 Në dokumenta, akte të tjera shpresore, fatura, njoftime dhe botime të tjera të nxjerra ose pranuar prej shoqërisë, emri i saj do të paraprihet ose pasohet nga:

- a. fjalët “Shoqëri me përgjegjesi të kufizuar” ose “Sh.p.k.”,
- a. numri unik i identifikimit (NIPT),

- b. vendndodhjen e selisë së regjistruar dhe të zyrës qendrore të saj, si dhe
- c. shënimin përkatës nëse kjo shoqëri është në likuidim.

1.5 Ortakët themelues të shoqërisë “FOREL” sh.p.k. janë:

- Vangjeli Kotonika
- Haxhire Kasaj
- Anisa Tahiraj

## **Neni 2**

### **Emri**

2.2 Emri i shoqërisë është **“FOREL” Sh.p.k.**, (më poshtë referuar si “Shoqëria”).

## **Neni 3**

### **Selia e Shoqërisë**

- 3.1 Selia e Shoqërisë është në adresën Rruga “ Xhemal Tafaj ” Nr.23 Tirane.
- 3.2 Shoqëria mund të hapë degë, përfaqësi, zyra dhe njësi në çdo vend brenda dhe jashtë Shqipërisë dhe do të zbatojë procedurat përkatëse ligjore dhe të regjistrimit.
- 3.3 Adresa e faqes së internetit të shoqërisë është : [webmail.forel.al](mailto:webmail.forel.al)  
Adresa e shoqërisë për qëllime komunikimi elektronik është si vijon:  
[info@forel.al](mailto:info@forel.al)

## **Neni 4**

### **Forma ligjore**

4.1 Shoqëria është shoqëri shqiptare dhe është krijuar si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar.

## **Neni 5**

### **Kohëzgjatja**

5.1 Shoqëria krijohet për një afat të pacaktuar.

## **Neni 6**

### **Objekti i Shoqërisë**

- 6.1 Aktiviteti kryesor i Shoqërisë do jetë:
  - Distribucion, shitje me shumicë dhe pakicë i artikujve farmaceutike, medikamente humane dhe veterinare, suplemente ushqimore, herbale, produkte kozmetike dhe

dermokozmetike, ortopedike, paisje dhe material mjekësore, elektromjekësore, laboratorike. Materiale kancelarie, mobilje, paisje elektrike, elektronike si dhe cdo aktivitet tjetër të lejuar nga legjislatiioni në fuqi;

- 6.2 Më tej, Shoqëria mund të zhvillojë cdo aktivitet të ligjshëm, i cili nuk lidhet drejtpërdrejtë me aktivitetin e Shoqërisë pa e përcaktuar atë me saktësi, duke ndjekur procedurat përkatëse për shtimin e objektit.

## **PJESA II**

### **KAPITALI THEMELTAR I SHOQËRISË DHE KUOTAT**

#### **Neni 7**

#### **Kapitali i Shoqërisë**

- 7.1 Kapitali fillestar i Shoqërisë është 100.000 lekë. Kapitali i shoqërisë është i përbërë nga 3(tre) kuota. Kjo kuota zotërohet si më poshtë:  
Vangjeli Kotonika – 1 kuota me vlerë 50.000 (pesëdhjetë mijë lekë)  
Haxhire Kasaj – 1 kuota me vlerë 25 .000 (njëzetë e pesë mijë lekë)  
Anisa Tahiraj – 1 kuota me vlerë 25 .000 (njëzetë e pesë mijë lekë)

### **III. STRUKTURA DREJTUESE**

#### **TE DREJTAT DHE DETYRIMET E ORTAKEVE**

#### **Neni 8**

#### **Përgjegjësia e kufizuar**

- 8.1 Ortakët janë përgjegjës deri në vlerën e pjesës së pashlyer të kapitalit të Shoqërisë. Shoqëria është përgjegjëse për detyrimet e saj me të gjitha asetet.

#### **Neni 9**

#### **Të drejtat e lidhura me cdo kuota**

- 9.1 Cdo pjesë/kuota e secilit ortak do t'i përgjigjet një votë korresponduese në mbledhjet e ortakëve, në përputhje me vlerën nominale të kësaj kuote, si dhe i jep ortakut zotëruar (në të njëjten masë) të drejtën për të marrë dividendë në rast shpërndarje të fitimit si dhe të drejtën e pjesës përkatëse që mbetet pas procedurave të likuidimit në rast prishje apo likuidimi të Shoqërisë.

## Neni 10

### E drejta e pjesëmarrjes në mbledhjet e Asamblesë

- 10.1 Ortakët (*ne rastin kur do te kete me shume se sa nje ortak*) kanë të drejtë të marrin pjesë në vendim-marrjen e Shoqërisë në mbledhjet e Asamblese.
- 10.2 Cdo ortak ka të drejtë të marrë pjesë në mbledhjet e Asamblese personalisht ose me prokurë, të informohet mbi çështjet e Shoqërisë si dhe të inspektojë dhe kontrollojë librat dhe regjistrat e Shoqërisë.

## Neni 11

### Detyrimet e Ortakëve

- 11.1 Ortakët kanë detyrim të paguajnë pjesën e tyre për shkak të pjesëmarrjes në kapitalin themeltar, të marrin pjesë në mbledhjet e asamblesë nëse ftohen në mënyrën e duhur, të mbështesin Shoqërinë në kryerjen e veprimeve të saj si dhe të përmbushin vendimet e mbledhjes së ortakëve dhe organeve të tjera të Shoqërisë të cilat janë marrë në mënyrën e duhur brenda qëllimit të organit përkatës.

## PJESA IV

### ASAMBLEJA ORTAKEVE

## Neni 12

### Të drejtat e asamblesë së ortakëve

- 12.1 Asambleja e ortakëve është organi më i lartë vendimmarrës i Shoqërisë e cila ka të drejtë të marrë vendime në lidhje me të gjitha çështjet e veprimtarisë së saj.
- 12.2 Asambleja e ortakëve përbëhet nga të gjithë ortakët (*ne rastin kur ka me shume se sa nje ortak dhe/ose nga nje ortak i vetem ne rastin kur ka vetem nje te tille*).
- 12.3 Vetëm asambleja e ortakëve ka të drejtë të vendosë për sa më poshtë:
  - (a) ndryshime dhe modifikime të Statutit;
  - (b) pranimin e ortakëve të rinj (pas rritjes së kapitalit apo transferimit të kuotave);
  - (c) vendimin mbi përjashtimin e një ortaku në përputhje me dispozitat përkatëse ligjore;
  - (d) të japë të drejta nënshkrimi dhe/ose mundësi zëvendësimi për aksionet në shoqëri.

- (e) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit themeltar dhe/ose cdo lloj pagimi të pjesëshëm ose subvencionin të dhënë nga ortakët;
- (f) bashkimin, ndarjen, prishjen dhe cdo lloj transformimi të Shoqërisë;
- (g) blerjen apo disponimin e interesit pjesëmarrës në shoqëri shqiptare apo të huaja;
- (h) hapjen dhe mbylljen e degëve dhe përfaqësive;
- (i) miratimin e raporteve vjetorë dhe bilancit të shoqërive si dhe shpërndarjen e fitimit;
- (j) blerjen, shitjen dhe dhënien peng të pasurive të paluajtshme;
- (k) marrjen me qira, dhënien me qira ose dhënien e cdo të drejte për përdorimin e pasurive të paluajtshme dhe ndërtesave;
- (l) të vendosë për investimet;
- (m) të japë letra me vlerë, të marrë detyrime, të lëshojë garanci ose letra sigurie;
- (n) të përcaktojë parimet e përgjithshme të politikave të shoqërisë;
- (o) të japë dhe të heqë (revokojë) prokura ose autorizime për të vepruar në emër të shoqërisë.
- (p) të caktojë shpërblimet për administratorët, të përfundojë kontratat e shërbimit me administratorët dhe nëpunësit ekzekutivë të shoqërisë.
- (q) të japë alternativa, të drejta të ndarjes së fitimit vjetor, pagesave në natyrë, të drejtat mbi pensionet ose pagesat mbi largimin e administratoreve dhe nëpunësve ekzekutivë të shoqërisë;
- (r) të përfundojë marrëveshje konsultimi dhe bashkëpunimi;
- (s) caktimin e auditorëve, ekspertëve kontabël dhe likuiduesve;
- (t) miratimin e rregullave të brendshme mbi administrimin;
- (u) ngritjen e padive kundër anëtarëve të organeve të Shoqërisë apo ortakëve;
- (v) përcaktimin e strukturës organizative dhe administrative të Shoqërisë;
- (ë) përcaktimin e buxhetit vjetor;
- (x) miratimin e cdo çështje tjetër zgjidhja e së cilës i është rezervuar asamblesë së ortakëve në përputhje me ligjin dhe këtë Statut.

12.4 Në cdo rast asambleja e ortakëve do të ketë të drejtë të vendosë mbi çdo çështje që tejkalon aktivitetin e përditshëm të shoqërisë.

### Neni 13

#### Vendimet e asamblesë së ortakëve

13.1 Vendimet e renditura përsa i përket ndryshimit të statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë merren me një shumicë më të lartë ose të barabartë se  $\frac{3}{4}$  e votave të ortakëve pjesëmarrës.

- 13.2 Në mbledhjet e ortakëve votimi është i hapur. Në raste të vecanta dhe për çështje të vecanta, një vendim mund të merret i fshehtë në përputhje me dispozitat ligjore.

#### Neni 14

##### Thirrja e asamblesë së ortakëve

- 14.1 Asambleja e ortakëve do të thirret nga administratorët të paktën njëherë në vit në selinë e Shoqërisë ose në cdo vend tjetër nëse përcaktohet në njoftim.
- 14.2 Gjithashtu, ortakët të cilët perfaqësojnë të paktën 5 për qind të totalit të votave në asamblenë e përgjithshme të shoqërisë mund t'i drejtojnë administratorëve një kërkesë me shkrim ose nëpërmjet postës elektronike për të thirrur asamblenë e përgjithshme. Në kërkesën drejtuar administratorëve mund të përfshihen dhe çështjet e posacme të rendit të ditës.
- 14.3 Asambleja e ortakëve do të thirret me anë të një njoftimi të shkruar të dërguar nga administratori/ët, njoftim ky i cili duhet të dërgohet ortakëve nëpërmjet një letre rekomande, telexi apo faksi jo më pak se 7 (shtatë) ditë përpara datës së caktuar të mbledhjes. Ftesa e shkruar do të regjistrohet në librin e procesverbalit të shoqërisë.
- 14.4 Ftesa për takimin e asamblesë së ortakëve do të tregojë datën kohën dhe vendin e takimit si dhe çështjet e rendit të ditës dhe, në rastin e një asambleje të zakonshme të ortakëve do të përfshijë gjithashtu dhe pasqyrat financiare dhe raportin e administrimit.
- 14.5 Nëse data për mbledhjen e ardhshme të asamblesë është vendosur në takimin e fundit dhe të gjithë ortakët kanë qënë prezentë, atëherë do të gjykohet sikur njoftimi është dërguar.
- 14.6 Nëse të gjithë ortakët janë prezentë në asamblenë e ortakëve, atëherë vendimet mund të merren dhe në mungesë të përmbushjes së kërkesave formale të caktuara më sipër nëse të gjithë ortakët prezent janë dakord për zhvillimin e saj, pavarësisht kesaj parregullsie.

#### Neni 15

##### Vendimet e marra në asamblenë e ortakëve

- 15.1 Vendimet në asamblenë e ortakëve të cilat kërkojnë një shumicë të zakonshme mund të merren vetëm nëse janë të pranishëm ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 % të kuotave. Vendimet në asamblesë e përgjithshme të

cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar mund të merrën vetëm nëse janë të pranishëm ortakët të cilët zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave.

- 15.2 Ne rastet e perfaqesimit me prokure, ajo duhet të jetë me shkrim dhe të paraqitet në mbledhjen e ortakëve. Administratorët e shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues të ortakëve në asamblenë e përgjithshme.
- 15.3 Cdo ortak ka të drejtë të thërrasë këshilltarë në mbledhjen e ortakëve, të cilet do të jenë të detyruar të ruajnë fshehtësinë e mbledhjes.
- 15.4 Nëse mbledhja e ortakëve thirret në mënyrë të rregullt por nuk plotësohet numri i ortakëve të caktuar për të përmbushur kuorumin, atëherë asambleja do të thirret përsëri në përputhje me Nenin 14 dhe gjithmonë jo më vonë se 30 ditë me të njëjtin rend dite.

#### **Neni 16**

##### **Drejtimi i mbledhjes se ortakeve**

- 16.1 Kryetari i mbledhjes së ortakëve do të caktohet nga Asambleja.
- 16.2 Do të aprovohen apo refuzohen vetëm ato çështje të cilat janë përcaktuar shprehimisht në rendin e ditës për mbledhjen e ortakëve. Diskutimet mbi çështje të ndryshme nga ato të rendit të ditës mund të bëhen vetëm nëse të gjithë ortakët japin pëlqimin e tyre.

#### **Neni 17**

##### **Procesverbali i mbledhjes së ortakëve**

- 17.1 Për cdo mbledhje të ortakëve do të mbahet një procesverbal dhe do të merren vendime. Procesverbali duhet të mbajë datën, vendin e mbledhjes, rendin e ditës, emrin e kryetarit dhe të mbajtësit të procesverbalit dhe rezultatet e votimit. Një kopje e procesverbalit do të përgatitet për Shoqërinë, një për regjistrin tregëtar dhe një për secilin ortak. Procesverbalit i bashkangjitet edhe lista e pjesëmarrësve së bashku me aktin e thirrjes së asamblesë së përgjithshme.
- 17.2 Procesverbali do të firmoset nga kryetari dhe kundërfirmoset nga sekretari që e mban atë.
- 17.3 Kopjet e vendimeve përkatëse të ortakëve do t'u dërgohen ortakëve me letër rekomande jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas takimit të ortakëve.

- 17.4 Administratori është përgjegjës për ruajtjen e kopjeve të procesvebalit dhe shpërndarjen e tij.

## PJESA V ADMINISTRIMI I SHOQËRISË

### Neni 18 Administrimi i Shoqërisë

- 18.1 Administrimi i shoqërisë do të bëhet nga një administrator, i cili do e përfaqësojë Shoqërinë individualisht. Asambleja e Ortakëve mund të vendosë që administrimi i shoqërisë mund të bëhet nga 2 ose më shumë administratorë.
- 18.2 Administratori mund të autorizoj palë të treta që ta përfaqësojë atë në transaksione të vecanta.
- 18.3 Administratori do të organizoj dhe menaxhojë të gjithë aktivitetin e Shoqërisë. Ai është i autorizuar të përfaqësojë Shoqërinë në të gjitha çështjet që kanë lidhje me objektin e aktivitetit të saj.
- 18.4 Të drejtat dhe detyrimet e administratorit burojnë nga ligji, ky Statut, vendimet e ortakëve dhe rregullat e brendshme të administrimit të Shoqërisë. Administratori mund të heqë dorë në çdo kohë nga detyra e tij, nëpërmjet një njoftimi me shkrim drejtuar asamblesë së përgjithshme. Administratori, që jep dorëheqjen, duke pasur parasysh rrethanat e veprimtarisë së shoqërisë, është gjithashtu i detyruar të thërrasë asamblesë të përgjithshme për emërimin e administratorit të ri, përpara datës në të cilën dorëheqja të hyjë në fuqi.
- 18.5 Duke marrë parasysh kufizimet e Nenit 12 më sipër, administratori ka të drejtat e mëposhtme:
- (a) përfaqësimin e Shoqërisë kundrejt palëve të treta dhe shtetit;
  - (b) hapjen e llogarive bankare të Shoqërisë me bankat;
  - (c) marrjen e huave në emër të Shoqërisë dhe vendosjen e kushteve të huasë,
  - (d) përfundimin e marrëveshjeve mbi dhënien e huave, pasi ka marrë miratimin me shkrim nga asambleja e përgjithshme;
  - (e) përfundimin e marrëveshjeve me palët e treta, lëshimin dhe marrjen e urdhër pagesave,
  - (f) nënshkrimin e të gjithë dokumentave, nxjerrjen e faturave, transferimet në monedhë të huaj, fletë ngarkesat etj, pagimin e detyrimeve të Shoqërisë dhe pranimin e letrave me vlerë nga palët e treta, duke patur parasysh kufizimet e mesipërme;



- (g) mbledhjen e detyrimeve që i takojnë shoqërisë, dhënien dhe marrien e paradhënieve;
- (h) punësimin dhe shkarkimin e stafit të Shoqërisë, përcaktimin e pagave, shpërblimeve dhe pagesave të stafit;
- (i) marrjen e masave paraprake për mbrojtjen e interesave të Shoqërisë, fillimin e padive dhe marrjen përsipër të mbrojtjes së Shoqërisë në rast të padive kundër saj; administratorët mund të udhëzojnë avokatët të mbrojnë Shoqërinë dhe mund të përcaktojnë shumën e shpërblimit të tyre, brenda kritereve të caktuara rast pas rasti nga Asambleja e Përgjithshme; administratorët kanë të drejtë të ngrenë padi dhe t'i tërheqin ato, të nënshkruajnë marrëveshje gjyqësore, të mbyllin marrëveshje arbitrazhi, të caktojnë arbitra, të tërheqin paditë e ngritura nga Shoqëria dhe të ndërprejnë procedimet;
- (j) administratorët kanë të drejtë marrin çdo vendim tjetër që i takon aktivitetit të përditshëm të Shoqërisë nga pikëpamja e ligjit dhe këtij Statuti;
- (k) mbledhjen e shpenzimeve të Shoqërisë;
- (l) administratorët janë përgjegjës për mbajtjen e llogarive në përputhje me ligjin dhe parimet e ligjit;
- (m) administratorët janë përgjegjës për përgatitjen dhe nënshkrimin e bilancit vjetor dhe pasqyrave vjetore financiare të Shoqërisë dhe kontrollin e tyre nga një auditor i jashtëm nëse dicka e tillë kërkohet nga ligji apo vendimi i mbledhjes së ortakëve;
- (n) thirrjen e mbledhjeve të ortakëve; përcaktimin e rendit të ditës; monitorimin e përmbushjes së dispozitave që kanë lidhje me thirrjen dhe drejtimin e mbledhjes së ortakëve për shpalljen e vendimeve të vecanta;
- (o) publikimin e shpalljeve të nevojshme përfshirë dhe publikimin e pasqyrave vjetore financiare;
- (p) administratorët janë përgjegjës për mbajtjen e rregullt dhe ruajtjen e dokumentacionit të Shoqërisë;
- (q) marrin vendime mbi të gjitha çështjet e tjera që lidhen me aktivitetin e brendshëm të Shoqërisë dhe marrëdhëniet e saj të jashtme, përveç atyre që u janë dhene Asamblese së Përgjithshme nga ky statut ose ligji.

18.6 Personi i mëposhtëm do të caktohet administrator për një periudhë 5 (pesë) vjetecare me të drejtë ripërtëritjeje:

- Zj. Vangjeli Kotonika, e bija e Dhimitër dhe Evgjeni, e dtl. 01.05.1940, Lindur në Korçë dhe banuese në Tiranë, madhore, me zotësi të plotë për të vepruar, identifikuar nëpërmjet kartës së identitetit nr.personal G E05501169Q, adresë: Rruga " Ali Pashë Gucia " Tiranë.

**PJESA VI**  
**VITI FINANCIAR, BILANCI, FITIMI DHE HUMBJET**

**Neni 19**

**Viti financiar, pasqyrat vjetore financiare**


- 19.1 Viti financiar i Shoqërisë zgjat 12 muaj dhe fillon në ditën e parë të Janarit dhe mbaron në ditën e tridhjetë e një të Dhjetorit. Viti i parë financiar i Shoqërisë fillon në datën e regjistrimit të Shoqërisë dhe mbaron në datën e tridhjetë e një-të të Dhjetorit.
- 19.2 Në fund të cdo viti financiar, administratorët do të përmbushin detyrat e mëposhtme:
- (a) përgatitjen e një liste të detajuar të asetëve të Shoqërisë dhe strukturës së tyre;
  - (b) përgatitjen e bilancit të shoqërisë i cili përshkruan situatën financiare të Shoqërisë;
  - (c) përgatitjen e llogarive të fitimit dhe të humbjeve.
- 19.3 Pasqyrat financiare të përgatitura do të paraqiten në mbledhjen e zakonshme të asamblesë së ortakëve së bashku me një raport të auditorëve të jashtëm për miratim.

**Neni 20**

**Fitimi i Shoqërisë**

- 20.1 Fitimi neto i Shoqërisë do të shpërndahet në përputhje me pjesët e kapitalit në Shoqëri si më poshtë:
- 50 % (pesëdhjetë përqind) e fitimit i takon Zj. Vangjeli Kotonika si pronar i 50% (pesëdhjetë përqind) të kapitalit të regjistruar të Shoqërisë.
  - 25%(njëzetëpesë përqind) e fitimit i takon Zj. Haxhire Kasaj si pronar i 25 % (njëzetëpesë përqind) të kapitalit të regjistruar të Shoqërisë.
  - 25 % (njëzetëpesë përqind) e fitimit i takon Zj. Anisa Tahiraj si pronar i 25 % (njëzetëpesë përqind) të kapitalit të regjistruar të Shoqërisë.

Me vendim te Asamblese se Pergjithshme vendoset ne lidhje me destinacionin e ketyre fitime;



- 20.2 Fitimi neto do të jetë fitimi i Shoqërisë në përputhje me pasqyrat vjetore financiare të miratuara pas zbritjes së të gjitha taksave dhe caktimit të rezervave ligjore. Bilanci i shoqërisë do të miratohet nga asambleja e ortakëve dhe do të dorëzohet në organet tatimore përpara fundit të muajit Mars të vitit pasardhës.

**PJESA VII**  
**PRISHJA DHE LIKUIDIMI**  
**Neni 21**  
**Prishja dhe likuidimi**

21.1 Shoqëria do të priset në rastet e mëposhtme:



- (a) me përfundimin e procedurave të falimentimit apo në rast të pamjaftueshmërisë së pasurive për të mbuluar shpenzimet e procedurës së falimentimit;
- (b) në rastet e pavlefshmërisë së themelimit të shoqërisë, sipas percaktimeve në ligj;
- (c) në baze të nje vendimi te mbledhjes së asamblesë së ortakëve;
- (d) bashkimi me një shoqëri tjetër;
- (e) në baze të nje vendimi të gjykatës kompetente;
- (f) në të gjitha rastet e tjera të parashikuara me ligj.

21.2 Likuidimi i Shoqërisë dhe shpërndarja e aseteve të Shoqërisë do të bëhet në përputhje me dispozitat ligjore.

**PJESA VIII**  
**TE PERGJITHSHME**

**Neni 22**  
**Legjislacioni zbatueshem dhe zgjidhja e mosmarreshjeve**

- 22.1 Në rast mosmarrëveshjes të cilat lindin si pasojë e këtij Statuti ose për shkak të ligjit, ortakët do të përipien t'i zgjidhin ato miqësisht. Në rast të kundert, mosmarrëveshja e ortakëve do të zgjidhet nga gjykata me juridiksion përkatës.
- 22.2 Ligji zbatues është ligji shqiptar.
- 22.3 Ky statut hartohet dhe nënshkruhet në 5 (pesë) kopje origjinale. Autorizohet Av. Klodiana Sanxhaku të kryejë procedurën ligjore të rregjistrimit pranë QKB.



**ORTAKËT E SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**

**VANGJELI KOTONIKA HAXHIRE KASAJ ANISA TAHIRAJ**

Vangjeli Kotonika Haxhire Kasaj Anisa Tahiraj  
